



Datë: 6 Mars 2023

## TERMA REFERENCE

### SHËRBIMI I KËRKUAR: LEHTËSUES PËR ORGANIZIM TË AKTIVITETEVE ME TË RINJ

#### 1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar më 8 Qershor 2022 me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 10 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

#### 2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore, më 1 Mars 2023, ka filluar implementimin e projektit: Femme Salon - "Tell me a story! – Inkurajojmë të rinjtë për të promovuar barazinë gjinore, diversitetin dhe gjithëpërfshirjen", mbështetur financiarisht nga Artivist Stafetë me fonde të Bashkimit Europian.

Në kuadër të projektit, **kërkohet të kontraktohet një lehtësues për realizimin e 6 eventeve me të rinj** që studiojnë në universitete ku do të ftohen persona publik apo aktivistë për të drejtat e njeriut të cilët do të ndajnë me studentët: 1) eksperiencat e tyre personale, motivimin për të punuar me çështje të barazisë gjinore, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes; 2) vështirësitë dhe sfidat e komunitetit të cilat ata i përkasin apo mbështesin në kontekstin shqiptar; 3) rëndësia, metodat dhe strategjitë për të vepruar në mbrojtje të komuniteteve të diskriminuara.

**Qëllimi i përgjithshëm i projektit:** të rrisim ndërgjegjësimin tek të rinjtë rreth çështjeve të barazisë gjinore, diversitetit, përfshirjes sociale dhe t'i motivojmë të bëhen agentë të ndryshimit në të ardhmen.

#### 3. PERIUDHA E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Shërbimi të ofrohet gjatë periudhës 1 Mars – 30 Prill 2023 dhe do të konsistojë në 6 ditë pune.

#### 4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Të lehtësojë në realizimin e 6 eventeve në universitete publike dhe private në Tiranë. Universitetet do të përcaktohen në bashkëpunim me Qendrën për Drejtësi Gjinore në Shqipëri;

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Medar Shtylla", Nd. 26/5, Ap. 77, Tiranë, Shqipëri

Web: [www.gjalbania.org](http://www.gjalbania.org); E-mail: [genderjusticealbania@gmail.com](mailto:genderjusticealbania@gmail.com); Tel: +355692667531



- Të ndërmjetësojë në komunikimin midis universiteteve, ekspertëve të ftuar në evente dhe Qendrës për Drejtësi Gjinore;
- Të mbajë kontaktet me universitetet dhe të sigurojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e pjesës logjistike;
- Të lehtësojë ekspertët e ftuar në sigurimin e logjistikës së kërkuar nga ta;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit akademik në evente;
- Të koordinojë punën për respektimin e datave dhe orareve të eventeve (të vendosura paraprakisht nga Qendra për Drejtësi Gjinore);
- Të jetë fleksibël për ndryshime të mundshme në data dhe orare të eventeve;
- Të ketë komunikim korrekt me palët e përfshira në projekt;
- Të mbështesë stafin e organizatës dhe të kontribuojë në raportimin final të projektit;
- Të përgatisë dhe dorëzojë timesheet për punën e kryer në përfundim të shërbimit të kërkuar.

## 5. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare (preferohet në shkencë sociale apo të komunikimit);
- Master shkencor apo profesional (preferohet në shkencë sociale apo të komunikimit);
- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune për organizim apo koordinim eventesh, aktiviteteve, etj.;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune në organizata të shoqërisë civile;
- Të zotërojnë njohuri shumë të mira të çështjeve gjinore, mos-diskriminimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Të zotërojnë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

## 6. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- CV (duke theksuar eksperiencat e mëparshme të punës/konsulencës për organizim eventesh, aktiviteteve, etj.);
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar.

**Adresë elektronike:** [genderjusticealbania@gmail.com](mailto:genderjusticealbania@gmail.com); [adena.vangjeli@gjalbania.org](mailto:adena.vangjeli@gjalbania.org)

**Adresë postare:** Rr. "Medar Shtylla", Nd. 26/5, Ap. 77, Tiranë, Shqipëri.

## 7. AFATET

**Afati për dërgimin e aplikimeve:** 12/03/2023, ora 17:00

**Njoftimi i aplikanëve:** 14/03/2023